

**STATUT DHE AKT-THEMELIM  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“3A-INFINITY & CO”**

Ky statut perpilohet nga ortaku:

**Armand LEKA**, i biri i **Novruz** i ditelindjes 28/07/1984., lindur ne Elbasan, dhe banues ne Durres. i pajisur me Karte Id nr. I40728078K, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te quajturit me poshte ortak themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me nenin 230 pika 2 e ligjit te ligji nr.9901 date date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, pershtat organizimin dhe funksionimin e shoqerise duke miratuar ndryshimet ne statut si me poshte:

**KREU I  
NENI 1  
FORMA**

Ortaket e mesiperm riorganizojne Shoqerine sipas formes ligjore me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2  
EMRI I SHOQERISE**


Emri i shoqerise do te jete **3A-INFINITY & CO SH.P.K**

**NENI 3  
SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Durresit me adrese: **Lagjja 13, Plazh ,nr.pasurie 38/217 Vol 100 faqe 29, Zona Kadastrale 8518.**

Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

24/01/2023



**NENI 4**  
**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar

**NENI 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Tregti me shumice dhe pakice te PVC dhe profileve te aluminit, te aksesoreve per dyer dhe dritare, xham-paketa.

Tregti te materialeve te ndertimit, tregti te makinerive, pajisjeve dhe pjeseve te kembimit per prodhimin e PVC dhe dograma alumini, marreveshje te ndermjetesimit tregtar dhe perfaqesimit. Komisioneri dhe veprimtari konsultative, furnizim, import-eksport te mallrave, veprimtari informatike dhe konsultative, prodhim dhe tregti me shumice dhe pakice i dyerve dhe dritareve, montim i dyerve dhe dritareve.


Veprimtari ekonomike në fushën e përpunimit aktiv dhe në fushën e përpunimit pasiv. Veprimtari në fushën e pasurive të paluajtshme nëpërmjet shitjes/blerjes/dhëniesmarrjes me qira të pasurive të paluajtshme, administrimit të pronave, dhënies apo marrjes me klering, zhvillimit të pronave duke përfshirë por pa u kufizuar në: ndërtimin e ndërtesave, rikonstruksionin, riparimin, etj. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përmbushur objektin e saj.

**KREU II**  
**KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT**  
**THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

**NENI 6**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themltar shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke i ndare ne 1 kuota.

- **Armand LEKA** I cili zoteron 1 kuote te perbere nga 1 pjese me vlere 100.000(njqind mije) leke .



## **NENI 7 KONTRIBUTET**

Kontributi percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti i takojne ortakeve themelues ne masen 100%

## **NENI 8**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen 100%.

## **NENI 9**

### **TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

## **KREU III**

### **MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

## **NENI 10**


### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit.

## **NENI 11**

### **DREJTIMI SHOQERISE**

24/01/2023





Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e aresyeshme. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

## NENI 12

### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve vendos per keto çeshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Si dhe per cdo ceshtje qe gjykon te aresyeshme
- Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortaket

## NENI 13

### ADMINISTRATORI

Shoqeria do te administrohet nga z. **Armand LEKA**, per nje afat 5 vjecare me te drejte riperteritje.


## NENI 14

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratoret e shoqerise emerohet nga asambleja e ortakeve te cilet pergjigjen per zbatimin e vendimeve te asamblese se ortakeve.

Administratoret e shoqerise kane keto kompetenca:

24/01/2023



- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq veprimtarinë e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi veprimtarinë e shoqërisë,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Asambleja,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerinë e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Asamblese.

Administratoret e shoqërisë janë të detyruar që vendimet në lidhje me koptencat e sipercituara të marrin vetëm bashkarisht me unanimitet.

## **KREUI V**

### **LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI**

#### **NENI 15**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabel që kërkon legjislacioni në fuqi edhe keto libra:


- 1- Libri i ortakëve, në të cilin shënohen emrat e plotë të Ortakëve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratoreve.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

#### **NENI 16**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundojë me 31 Dhjetor. Llogaritë vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga asambleja e ortakëve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

24/01/2023



**KREU V**  
**NENI 17**  
**AKTIVITETI FINANCIAR**

Ne çdo mbyllje të çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim Bilancit i bashkëngjiten:

- a. Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria,
- b. Një situacion mbi sigurimet e bërë nga shoqëria,

Raporti i administratoreve përfshijë gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të eksperteve kontabel të autorizuar, të pakten një muaj para mbledhjes së asamblese.

**NENI 18**

Fitime neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, shoqërore, demet, amortizimet, etj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta financimi.


Perberja, shumat e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezerve, përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë caktohet nga asambleja e ortakeve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar lihet menjëherë një shumë me vlerë 1/20 e cila destinohet për krijimin e një fondi "rezerve e domosdoshme".

**NENI 19**  
**PRISHJA E SHOQËRISE**

Shoqëria priset për arsye të parashikuara në ligj. Shoqëria priset përpara afatit me vendim të Asamblese Ortakeve .

**NENI 20**





Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

#### **NENI 21**

Kur shoqeria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

#### **NENI 22**

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

#### **NENI 23**

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

#### **NENI 24**


Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

#### **NENI 25**

### **DISPOZITA TE FUNDIT**

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te

24/01/2023



lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.


Durres me 24/01/2023.

Ortaku i Shoqerise:

**Armand LEKA**

Armand

Jeta



24/01/2023